



Pranuar / Dorezuar Priljena/Pridato Received/Delivered	27-01-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHCK	372/2022		1/4

Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.1171/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti –anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1177/2021 të datës 16.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit KA.nr.16/2021 të datës 26.11.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e papabuzuar ankesa me numër A.nr.1177/2021 e datës 16.12.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KA.nr.16/2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 26.11.2021.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 16.08.2021 ka shpallur konkursin me referencë: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-014 për pozitën “Zyrtar Ligjor 2 për 2 (dy) pozita -në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit” në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cila është ftuar të marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë mirëpo nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm.

Më datën 26.10.2021 Sekretari i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka bërë publik njoftimin për kandidatët e suksesshëm.

I pakënaqur me njoftimin e datës 26.10.2021, ankuesi më datë 03.11.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 26.11.2021 nxjerr Vendimin me numër KA.nr.16/2021 me të cilin ka refuzuar si të papabuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.nr.6/2021 të datës 26.11.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 16.12.2021 ka parashtruar

ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokoll 6173/2021 me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit lidhur me konkursin e lartë cekur është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është zbatuar sipërfaqësisht si dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.01.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sekretari i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 14.01.2022 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër:160/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e datës 16.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër KA.nr.16/2021 i datës 26.11.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.01.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 15.11.2021; Konkursin e datës 16.08.2021; vendimin e datës 02.09.2021 me numër prot: DPSKPK/282/2021 për themelimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil; Njoftimin e datës 06.09.2021 për kandidatët që kanë hyrë në listën e ngushtë; Regjistri i njoftimit për testimin me shkrim i datës 07.10.2021; Regjistri i njoftimit për testimin me gojë i datës 15.10.2021; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të datës 26.10.2021; regjistrin e aplikacioneve të pranuar i datës 30.08.2021; Listën përfundimtare të përzgjedhjes për listën e ngushtë e datës 30.08.2021; Formularët Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual përfundimtar të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 26.10.2021; Formulari për përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit dhe intervistës; Dëshminë për dorëzimin e aplikacionit e datës 25.08.2021; Aplikacionin e punësimit të datës 25.08.2021 të ankuesit; Diplomë e ankuesit numër:6162 të datës 28.03.2019; Referencën e datës 24.05.2021; referencën e datës 25.05.2021; Çertifikatën e datës 24.08.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë-dega Malishevë; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Çertifikatën e datës 12.07.2020; Dëshminë për dorëzimin e aplikacionit e datës 01.09.2021; Aplikacioni për punësim i datës 30.08.2021 për kandidaten _____ Diplomën e datës 14.09.2017 me numër:4894; Vërtetimin e datës 15.07.2021; Vërtetimi i datës 18.06.2021; Çertifikatën e datës 18.11.2019; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dega Prishtinë e datës 19.03.2021; Dëshminë për dorëzimin e aplikacionit të datës 30.08.2021; Aplikacionin për punësim i kandidates _____ i datës 30.08.2021; Diplomën e kandidates _____ e datës 18.11.2019; Diplomën e datës 03.07.2015; Pasqyrën e notave e datës 13.11.2019 lëshuar nga Kolegji UBT; Çertifikata e datës 18.02.2021; Letër referencat e lëshuara nga gjyqtari _____ dhe _____ dhe Diplomën e datës 1.10.2011; Diplomën e datës 20.10.2007; Diplomën e datës 14.04.2011; Diplomën e datës 11.07.2008; Diplomën e datës 10.05.2010; Diplomën e datës 03.11.2010; Diplomën e datës 23.10.2009; Çertifikatën e datës 27.08.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Istog; Kopjen e letërnjoftimit të kandidates _____ Deklarata për mos ekzistimin e konfliktit të interesit e datës 09.10.2021, testin me shkrim të datës 09.10.2021 për kandidaten _____ Deklarata për mos ekzistimin e konfliktit të interesit e datës 09.10.2021 e kandidates _____ Testin me shkrim të kandidates _____ i datës 09.10.2021; Deklarata për mos ekzistimin e konfliktit të interesit e datës 09.10.2021 e ankuesit, Testin me shkrim të ankuesit i datës 09.10.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit _____ është e pa bazuar,
sepe:



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 16.08.2021 ka shpallur konkursin me referencë: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-014 për pozitën *“Zyrtar Ligjor 2 për 2 (dy) pozita-në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit”*, ndërsa si kriteret e kualifikimeve arsimore dhe profesionale për këtë pozitë është kërkuar: *“Diplomë Universitare-Fakulteti Juridik dhe Një (1) vit përvojë pune profesionale”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesi me datë 25.08.2021 ka aplikuar në konkursin e lartë cekur dhe po ashtu i njëjti sipas Diplomës me numër: 6162 të datës 28.03.2019 dëshmohet se i ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të “Universitetit të Prishtinës” me datë 19.02.2019, ndërsa sa i përket përvojës së punës i njëjti posedon Çertifikatën e datës 12.07.2020 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë sipas të cilët dëshmohet se ka kryer praktikën gjyqësore nga data 13.05.2019 deri me datë 12.05.2020 në kohëzgjatje 1 (një) vjeçare dhe konstatohet se ankuesi ka përvojë të punës prej 1 (një) viti pas diplomimit. Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës të administruara dhe të evidentuara në këtë vendim, të dy (2) kandidatët e përzgjedhur sipas njoftimit të datës 26.10.2021 për pozitën *“Zyrtar Ligjor 2 -në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit”* i kanë plotësuar kriteret e konkursit, kanë të mbaruar Fakultetin Juridik dhe kanë më shumë se një (1) vit përvojë pune pas diplomimit, andaj me rastin e përfshirjes në listën e shkurt sikurse të ankuesit ashtu edhe të dy (2) kandidatëve të përzgjedhur, Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 i cili ka përcaktuar se: *“1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës”* pasi që ka vlerësuar drejtë përmbushjen e kriterëve të konkursit nga kandidatët e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në provat e lëndës ka gjetur se në bazë Regjistrit të njoftimit të datës 07.10.2021 ankuesi është njoftuar përmes telefonit se i njëjti është përfshirë në listën e shkurt dhe është ftuar në testin me shkrim i cili është mbajt me datë 09.10.2021, ndërsa ankuesi në bazë të Formularit Form.MAP-SHCK-08a i datës 26.10.2021 është vlerësuar në testin me shkrim me 73 (shtatëdhjetë e tre) pikë dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se me rastin e ftesës për intervistim me gojë e dëshmuar nga institucioni punëdhënës përmes Regjistrit të njoftimit të datës 15.10.2021 Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 36 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *“Kandidatët të cilët e kalojnë me sukses testimin me shkrim dhe arrijnë të mbledhin së paku 50 % të maksimumit të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë të testit me gojë...”*, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 41 paragrafi 5 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil me arsyetimin se nuk kishte listë të kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim, është i pabazuar ngase neni 41 paragrafi 5 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të cilës i referohet ankuesi ka të bëjë me *“komunikimin me kandidatët e përzgjedhur dhe shpalljes së rezultateve të procedurës së rekrutimit”* dhe se me rastin e interpretimit të normës juridike ankuesi duhet ta ketë parasysh ndërlidhjen komulative ndërmjet nenit dhe të gjithë paragrafëve të tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të Formularit të përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës të kandidatëve i datës 26.10.2021, ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur si më e vlerësuara është me (84.5) pikë, ndërsa kandidatja e dytë e përzgjedhur është vlerësuar me (82.9) pikë, ndërsa ankuesi si pikë të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë ka arritur të grumbullojë gjithsejtë (56.4) pikë dhe është renditur i katërmëdhjeti (14) me radhë, me çka konstatohet se ankuesi nuk ka arritur pikë të mjaftueshme që të jetë në mesin e dy kandidatëve të përzgjedhur siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 të Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 40 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*.

Andaj mbi bazën e të gjeturave si më lart, Kolegji ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën *“Zyrtar Ligjor 2 për 2(dy) pozita -në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit”* e shpallur me datë 16.08.2021 në konkursin me referencë: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-014 nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të

Kosovës, është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve” si dhe neni 18 paragrafi 1 i të njëjtit ligji i cili përcakton se: “Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”, ndërsa ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe si e tillë është refuzuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër KA.nr.16/2021 të datës 26.11.2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik pasi që kandidatja e përzgjedhur A.C është në lidhje/raport familjar me prokurorin R.M, Kolegji vlerëson se institucioni përgjegjës për të trajtuar kërkesa të natyrës së tillë është Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit siç përcaktohet në neni 7 paragrafin 1 të Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik ku përcaktohet se: “Identifikimi i konfliktit të interesit dhe burimi i informatave 1. Pavarësisht çdo detyrimi tjetër ligjor, çdo person që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm për konflikt interesi të ndonjë zyrtari duhet ta lajmërojë institucionin punëdhënës të zyrtarit ose Agjencinë kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia)”, andaj mbi këtë bazë ankuesi mund t’i drejtohet institucionit respektiv me kërkesë të veçantë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në neni 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe neni 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.1177/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

